



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE NGRITJE NË DETYRË

Në zbatim të nenit 20 dhe të nenit 21 të Kreut IV, të ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të kreut II, IV dhe VII të VKM nr. 242 datë 18/03/2015 “Për Plotësimin e vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese”, të ndryshuar, Bashkia Divjakë shpall procedurën për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë për pozicionin:

“1 Përgjegjës Buxheti, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

***Pozicioni i lartpërmendur ju ofrohet fillimisht nëpunësve civil të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.**

***Vetëm në rast se për këtë pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se vendi është përsëri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.**

Datë mbyllet 14.10.2022 dorëzimi i të gjithave dokumentave për lëvizje paralele

Datë mbyllet 19.10.2022 dorëzimi i të gjithave dokumentave për ngritjen në detyrë

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin, “1 Përgjegjës Buxheti, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

1. Të njoh dhe të përditësoj legjislacionin për buxhetin dhe programin buxhetor afatmesëm.
2. Të jetë drejtues në planifikimin e buxhetit vjetor dhe PBA-së 2023-2025.
3. Të plotësojë pasqyrat e buxhetit sipas standarteve të kërkuara nga Ministria e Financave, duke përcaktuar treguesit ekonomik dhe financiar.

4. Të mbledh dhe të përpunojë informacionin nga Drejtoritë dhe Sektorët duke u mbështetur në platformën elektronike të Kryetarit të Bashkisë dhe në Planin e Përgjithshëm Vendor.
5. Të përgatis dokumentin përfundimtar të buxhetit 2023 dhe PBA-së 2023-2025.
6. Të njoh dhe të përditsojë legjislacionin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e buxhetit.
7. Të rakordojë me kordinatorin e riskut për krijimin e rregjistrimit të riskut, vlersimin, kontrollin e risqeve që ve në rrezik rritjen e objektivave.
8. Të kryqëzojë informacionin mbi mbajtjen e sistemit të kontabilitetit me Përgjegjësin e Financës për aktivet.
9. Të bëjë rakordimin me Drejtorin e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për garantimin e mbledhjes së borxheve të paarkëtuara.
10. Të bëjë rakordimin me Drejtorinë e Financës për pagesat e kreditorëve.
11. Të kryejë kontrollin për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve, për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të humbjes, vjedhjeve etj..

LËVIZJA PARALELE

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil brenda të njëjtës kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA:

1. Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele në detyrë janë:

- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën një vlerësim “mirë” ose “shumë mirë”.
- Të plotësojë kriteret e veçanta për konkurim në shërbimin civil.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a-** Të zotërojnë diplomë në nivelin “Master Shkencor ose Profesional” në Shkenca Ekonomike, Financë ose në fusha të tjera të përshtatshme me natyrën e punës. (Diplomët të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucioneve përgjegjëse për njehësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b-** Të ketë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune në administratë publike ose në profesion.
- c-** Të kenë njohuri të një gjuhe të huaj.

- d- Të ketë aftësi të mira komunikuese.
- e- Të ketë aftësi për të punuar në grup.
- f- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- g- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë njohuri të gjëra të legjislacionit në tërësi dhe njohuri shumë të mira të procedurave administrative.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrimi (CV)
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomi, Financë ose në fusha të tjera të përshtatshme me natyrën e punës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt “mire” apo “shumë mirë”.
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Fotokopje e librezës së punës.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet dorazi pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Bashkia Divjakë dhe afati për pranimin e dokumentave për lëvizjen paralele është deri më datë 14.10.2022 e pëcaktuar duke filluar që nga data e shpalljes.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK.

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele në detyrë dhe të përmbushjes së kriteve specifike të vendit të punës do të dalin në datën **17.10.2022** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit Lushnje”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e njoftimeve pranë Bashkisë Divjakë, gjithashtu kandidatët do të njoftohen dhe individualisht.

Në të njëjtën datë do të njoftohen individualisht kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e posaçme, nëpërmjet adresës së e-mail.

Ankesat nga kandidatet paraqiten pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme brenda 3 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSIVE DHE CILËSIT MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidati do të vlerësohet në lidhje me:

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

2. Ligji Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

3. Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

4. Ligji Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administrimin publik”.

5. Ligji Nr.9367, datë 07.04.2000 “Për parandalimin e konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

6. Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

7. Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

8. Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

9. Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin e Financave dhe Kontrrollin”, i ndryshuar.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJEN PARALELE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar si më poshtë:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën, si dhe vlersimet pozitive në punë dhe totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Kandidati që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë konsiderohet fitues.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në stendën e Bashkisë, faqen zyrtare të Bashkisë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit Lushnje”.

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që janë nëpunës civil të konfirmuar dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta sipas Kreut III Të Vendimit nr.242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministarve, “**Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese**”, të ndryshuar.

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar.
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mire” ose “Shume mirë”.
- Të ketë njohuri të pogramëve bazë kompjuterike në Word dhe Exel
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për Nepunësin Civil”, i ndryshuar;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon;

- Të zotëroj diplomë të nivelit “Master Skencor ose Master Profesional” në Shkenca Ekonomike, Financë ose në fusha të tjera të përshtatshme me natyrën e punës (Diplomët të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucioneve përgjegjëse për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a -Jetëshkrim (CV)

b - Fotokopje të diplomës dhe listës së notave“Master Skencor” në Shkenca Ekonomi, Financë ose në fusha të tjera të përshtatshme me natyrën e punës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) nëse ka;

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme për procedurën e pranimit në kategorinë e ulta dhe të mesme drejtuese duhet të bëhet brenda dates 19.10.2022.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pas përfundimit të afatit të dorëzimit do të shpallen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit Lushnje” dhe në stendën e bashkisë si dhe në faqen zyrtare të bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail)

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar.

2. Ligji Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

3. Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

4. Ligji Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administrimin publik”.

5. Ligji Nr.9367, datë 07.04.2000 “Për parandalimin e konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

6. Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

7. Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

8. Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

9. Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollin”, i ndryshuar.”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë

b - Për dokumentacioni e dorëzuar deri në 20 pikë

c - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratën dhe pritshmërit e tyre për karrierën, deri në 40 pikë.

Kandidati që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë konsiderohet fitues.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Divjakë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit Lushnje”, në stendën e informimit të institucionit si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jofitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës të përcaktuar në shpallje duke filluar nga dita e parë e shpalljes në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit Lushnje” në stendën e informimit të institucionit si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Njësia përgjegjëse bën verifikimet paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuar në shpalljen për konkurim.

Shpallja e procedurës së pranimit botohet të paktën 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurimit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë do të njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, për fazat e mëtejshme të procedurës e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme tek afishimi i njoftimeve tek “Shërbimi Kombëtar i Punësimit Lushnje”, stenda pranë Bashkisë Divjakë, si dhe në faqen zyrtare të bashkisë.